HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

TRANSPARENCA FORMALE E UNIVERSITETEVE PUBLIKE *2024*



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6

Autorë:
Gramos Buçinca & Olisa Çekaj

Prishtinë, maj 2024

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!"

Faik Konica

Përmbajtja

05 **Hyrje**

07 **Të gjeturat e përgjithshme**

10 **Krahasimet me vitet e kaluara**

11 **Karakteristikat për secilin institucion**
12 Universiteti i Prishtinës
13 Universiteti i Prizrenit
14 Universiteti i Gjilanit
15 Universiteti i Pejës
16 Universiteti i Mitrovicës
17 Universiteti i Gjakovës
18 Universiteti i Ferizajt
19 Kolegji IBC-M

20 **Dokumentet dhe Informacionet e kërkuara**

31 **Metodologjia**

Hyrje

Mesatarisht mbi 95% e institucioneve publike të arsimit të lartë financohen nga taksapaguesi dhe më pak se 5% mund të gjenerojnë të hyra vetanake.. Kjo do të thotë që shumica dërrmuese e faturave të tyre paguhen nga qytetarët Kosovar që nuk janë bëjnë pjesë aty. Për këtë gjë universitetet dhe kolegjet publike vendosen nën llupën e organizatave që monitorojnë shpenzimin e parasë publike.

Transparenca formale, ku rregulloret, njoftimet, informatat dhe dokumentet e tjera janë të qasshme në kohë reale nga qytetarët kosovar që janë ose jo pjesë e atij institucioni publik, ul rrezikun për keqpërdorime dhe rritë cilësinë. Studentët dhe stafi ndihen të mbrojtur dhe të mbështetur kur ata e kanë të qartë se çfarë procedura duhet të përcjellin në rastet kur është bërë shkelje ndaj tyre. Andaj, ORCA ka identifikuar 28 dokumente apo informacione të cilat janë kyçe për të cilësuar një universitet apo kolegj publik si formalisht transparent.

Ky hulumtim është mundësuar në kuadër të projektit HEI25, i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës dhe Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim.

Të gjeturat e përgjithshme


Me ngjyrë të gjelbër janë shënjuar dokumentet apo informatat të cilat kanë pasur qasje të tërësishme. Me ngjyrë portokalli janë shënjuar dokumentet apo informatat të cilat kanë pasur qasje të pjesshme, ose kanë ekzistuar të publikuara vetëm për një kohë të caktuar. Me ngjyrë të kuqe janë shënjuar dokumentet apo informatat të cilat nuk kanë qenë të publikuara.

	Prishtinë	Prizren	Gjilan	Pejë	Mitrovicë	Gjakovë	Ferizaj	IBCM
Raporti student/mësimdhënës	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Statuti i Universitetit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Plani Strategjik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Kodi i Etikës	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Rregullore Disiplinore	✓	✓	✓	✗	✓	✓	✓	
Rregullore për Zgjedhjen dhe Avancimin e Stafit Akademik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	

	Prishtinë	Prizren	Gjilan	Pejë	Mitrovicë	Gjakovë	Ferizaj	IBCM
Rregullore për Bashkëpunëtorë të Jashtëm	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗	
Buletinet për Stafin Akademik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
CV-të e Stafit Akademik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗	
Rregullore për të Ardhurat Personale	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗	
Buxheti	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Rregullore për Zgjedhjet Studentore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Përbërja e Parlamentit Studentor	✓	✓	✗	✓	✓	✓	✓	
Përbërja e Rektoratit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Përbërja e Këshillit Drejtues	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Përbërja e Senatit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Vendimet e Senatit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗	
Vendimet e Këshillit Drejtues	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗	
Vendimet e Rektorit	✓	✗	✓	✓	✓	✓	✗	

	Prishtinë	Prizren	Gjilan	Pejë	Mitrovicë	Gjakovë	Ferizaj	IBCM
Vendimet e Akreditimit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Rregullore për Studimet Baçelor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Rregullore për Studimet Master	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Rregullore për Studimet Doktorale	✓	✗	✗	✓	✗	✓	✗	
Rregullore për Sigurimin e Cilësisë	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Rregullore për Sistemin Elektronik të Menaxhimit Studentor	✓	✓	✗	✗	✓	✗	✓	
Planprograme	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Info për Bursa/Punësim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	
Rregullorja kundër Ngacmimeve Seksuale	✓	✗	✗	✗	✗	✗	✓	
Indeksi	**28**	**25**	**24**	**25**	**26**	**26**	**21**	**1**

Krahasimet me vitet e kaluara



Karakteristikat për secilin institucion

Përveç Universitetit të Prishtinës asnjë institucion tjetër nuk ka ofruar studime të doktoratës në kohën e hulumtimit, ndërkaq Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj nuk parasheh studimet të tilla fare.

Rregullore kundër ngacmimeve seksuale nuk kanë poseduar në uebfaqe asnjë institucion përveç Universitetit të Prishtinës dhe atij të Ferizajit. Buxhetin nuk e publikon asnjë institucion. Buxheti i tyre mund të shihet në ligjin për buxhet të institucioneve publike.

Asnjë institucion nuk e publikon totalin e studentëve dhe të stafit akademik, duke e pamundësuar kështu njoftimin me raportin profesor për studentë. ORCA posedon numrin e stafit akademik për secilin institucion nga hulumtimet e saja, ndërkaq numri i studentëve mund të gjendet në Agjencinë për Statistika të Kosovës.

Universiteti i Prishtinës

24
2019

27
2020

25
2021

24
2022

28
2024

Universiteti i Prishtinës ka të gjitha dokumentet e publikuara, 28 dokumente të publikuara nga 28 në vitin 2024, në krahasim me vitin 2022 ku ishin të publikuara vetëm 24 dokumente. Buletinet e Universitetit të Prishtinës edhe pse kanë një seksion të dedikuar për publikimin e tyre, në krahasim me universitetet e tjera publike në Kosovë, buletinet janë të qasshme vetëm në periudhën e avancimeve. Në Universitetin e Prishtinës jo të gjitha silabuset janë të publikuara. Në fakultetet përkatëse të Universitetit ofrohet vetëm një pasqyrë e lëndëve dhe fushës së drejtimeve në nivelet Baçelor dhe Master, ndonëse rrallë herë gjenden planprogramet dhe silabuset. Në listën e dokumenteve dhe rregulloreve, Universiteti i Prishtinës ka aprovuar rregullorën për parandalimin dhe mbrojtjën nga ngacmimi seksual dhe nga ngacmimi.

Universiteti i Prizrenit

23

2019

23

2020

24

2021

25

2022

25

2024

Në vitin 2024, Universiteti i Prizrenit ka të publikuar 25 dokumente nga 28, ende qëndron njejtë me numrin e dokumenteve të publikuara në vitin 2022 ku në faqen e tyre ishin të publikuara vetëm 25 dokumente. Në faqen e Rektorit të Universitetit të Prizrenit, edhe pse ekziston seksioni mungojnë vendimet e rektorit. Përveç vendimeve të Agjencisë së Akreditimit rreth programeve të akredituara në universitet, faqja e universitetit mundëson në një seksion të veçantë qasjën në një tabelë e cila shfaqë të gjitha programet e akredituara, duke renditur emrat e tyre, nivelet e studimit, kreditë si dhe datat e skadimit të akreditimit. I gjithë stafi akademik i Universitetit të Prizrenit ka të vendosura CV-të në faqet e tyre të fakulteteve përkatëse. Në listën e dokumenteve dhe rregulloreve ende mungon rregullorja kundër ngacmimeve seksuale.

Universiteti i Gjilanit

19

2019

22

2020

23

2021

24

2022

24

2024

Në vitin 2024, Universiteti i Gjilanit ka të publikuar 24 dokumente nga 28, nuk ka ndryshime në rritje apo rënie të numrit të dokumenteve të publikuara në vitin 2022. Në pjesën përbërëse të Parlamentit Studentor të Universitetit të Gjilanit, figuron vetëm informata mbi kryetarin e Parlamentit Studentor, ndërsa për trupën përbërëse të tij nuk ka informacion. Universiteti i Gjilanit ofron për të gjitha programet e studimit sillabusin, mirëpo nuk figuron asnjë informacion rreth planprogrameve. I gjithë stafi akademik i Universitetit të Gjilanit ka të vendosura CV-të në faqet e tyre të fakulteteve përkatëse. Në listën e dokumenteve dhe rregulloreve ende mungon rregullorja kundër ngacmimeve seksuale.

Universiteti i Pejës

23

2019

26

2020

22

2021

25

2022

25

2024

Nga 28 dokumente sa janë paraparë, në vitin 2024 Universiteti i Pejës kishte të publikuara vetëm 25 dokumente aq sa kishte të publikuara edhe në vitin 2022. Kjo tregon që universiteti në fjalë, nuk e ka përditësuar uebfaqen e saj. Universiteti i Pejës nuk ka të publikuar rregullore disiplinore për stafin akademik, ndonëse kodi etik është i publikuar. Universiteti i Pejës nuk ka rregullore për Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU) të publikuar. Ndërsa për nga përbërja e stafit, i gjithë stafi akademik i këtij universiteti ka të vendosura CV-të në faqet e tyre të fakulteteve përkatëse. Universiteti i Pejës ende nuk ka një rregullore kundër ngacmimeve seksuale të publikuar.

Universiteti i Mitrovicës

22
2019

25
2020

22
2021

25
2022

26
2024

Universiteti i Mitrovicës ka të publikuar 26 dokumente në vitin 2024 nëse e krahasojmë me të dhënat e nxjerra në vitin 2022 ka pësuar një rritje të lehtë, ky universitet kishte të publikuar 25 dokumente. Në seksionin informues mbi përbërjen e rektorati, nuk figurojnë emrat dhe informacionet e prorektorëve, ndonëse informacioni mbi rektoren ekziston. I gjithë stafi akademik i Universitetit të Mitrovicës ka të vendosura CV-të në faqet e tyre të fakulteteve përkatëse. Ndonëse ekziston një vendim i vitit 2022 për formimin e një komisioni për hartimin e rregullores kundër ngacmimeve seksuale, mirëpo rregullorja ende nuk është finalizuar apo publikuar.

Universiteti · University
FEHMI AGANI
GJAKOVË

21
2019

25
2020

25
2021

25
2022

26
2024

Universiteti i Gjakovës

Universiteti i Gjakovës ka pësuar një rritje të lehtë për nga numri i dokumenteve, nga 25 sa ishin në vitin 2022 tani janë 26 dokumente të publikuara në faqen e tyre. Mungojnë pjesshëm informacionet rreth raportit student/mësimdhënës dhe buletinet për 5 vitet e fundit. Ndërsa në këtë universitet ende nuk ka rregullore të publikuar për Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU) si dhe nuk ka të publikuar rregullore kundër ngacmimeve seksuale.

UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Universiteti i Ferizajt

8
2019

16
2020

15
2021

15
2022

21
2024

Universiteti i Ferizajt ende qëndron si njëri ndër universitetet me më së paku transparencë në mesin e universiteteve të tjera publike, edhe pse në krahasim me vitet e kaluara, UShAF ka pësuar një rritje të dukshme të publikimit të dokumenteve pra nga 15 dokumente sa ishin në vitin 2022 tani janë 21. Gjithashtu Universiteti i Ferizajit ka të vendosura në uebfaqen e tyre në seksionin e stafit akademik vetëm biografitë e shkurtra të profesorëve dhe jo CV-të e tyre. Në këtë universitet uebfaqja nuk jep informacione mbi vendimet e Senatit, Rektoratit, Këshillit Drejtues dhe organeve tjera të Universitetit. Gjithashtu mungojnë rregulloret për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe rregullorja mbi të ardhurat personale të stafit akademik, mirëpo ekziston rregullorja kundër ngacmimeve seksuale si dhe parandalimit të tyre brenda UShAF.

Kolegji IBC-M

1

2024

Kolegji Ndërkombëtar për Biznes në Mitrovicë ka funksionuar si kolegj jo publik deri në mars 2023 kur Qeveria e Kosovës e ka transformuar në kolegj publik. Si i tillë, kolegji është në fazën e hartimit të rregulloreve dhe dokumenteve të tjera të cilat nuk i ka poseduar gjatë kohës së hulumtimit. Buxheti i tij po ashtu nuk figuron në ligjin për ndarje buxhetore, por financimin e ka të ndarë nga një buxhet i Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.

Dokumentet dhe Informacionet e kërkuara

1. **Raporti student për mësimdhënës** është informacion i rëndësishëm për të kuptuar ngarkesën e punës së mësimdhënësve. Numri i ulët i studentëve për mësimdhënës është indikator i cilësisë së mirë. Ky raport po ashtu tregon nevojën për shtimin ose ri-organizimin e stafit brenda universiteteve.

2. **Statuti i Universitetit** është dokumenti themelor qeverisës i universiteteve publike. Të gjitha rregulloret dhe udhëzimet e tjera derivojnë nga ai. Si i tillë, është e rëndësishme që Statuti të jetë i qasshëm për studentët dhe stafin akademik, në mënyrë që ata të jenë të informuar për të drejtat e tyre themelore.

3 **Plani Strategjik** është udhërrëfyesi i zhvillimit të universiteteve. Këtu përshkruhen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara për tri deri në pesë vitet e ardhshme. Publiku mund ta kuptoj orientimin e universitetit përmes dokumentit të planit strategjik.

4 **Kodi i Etikës** është manuali i sjelljes së stafit dhe studentëve. Kodi i Etikës përfshinë vlerat, parimet bazë, sjelljet e pa papranueshme si dhe mekanizmat disiplinues për ata që bëjnë shkelje. Kodi i Etikës është baza kryesore ligjore mbi të cilën mund të ngrihen kallëzime pranë organeve të universitet, si rrjedhojë është njëri nga dokumentet kyçe që i mbështetë studentët dhe stafin kundër keqpërdoruesve.

5 **Rregullorja Disiplinore** përmban procedurën se si duhet të trajtohen shkeljet, si dhe bën kategorizimin e shkeljeve të rënda dhe të lehta. Po ashtu, përcakton se cili organ është përgjegjës për secilën fazë të trajtimit të shkeljes

përfshirë edhe nivelet e ndështkimit dhe mekanizmat e ankimit. Rregullorja shërben si mjet për studentët dhe stafin për të hartuar kallëzime kundër keqbërësve.

6 **Rregullorja për Zgjedhjen dhe Avancimin e Stafit Akademik** përcakton kriteret dhe procedurën e punësimit dhe avancimit të stafit akademik. Stafi cilësor akademik është indikatori kryesor i cilësisë së një universiteti. Zbatimi i rregullave dhe i kritereve të kësaj rregullore është esencial në prurjen e njerëzve adekuat në universitet, si dhe promovimin e profesorëve e asistentëve meritor të cilët kanë treguar rezultate në publikime shkencore.

7 **Rregullorja për Bashkëpunëtorë të Jashtëm** rregullon angazhimin me kontratë të përkohshme, për ligjërata ose ushtrime. Të njëjtëve shpesh ju caktohet përgjegjësia e përpilimit të provimeve, mbajtjes dhe vlerësimit të tyre. Kjo tregon se bashkëpunëtori i jashtëm është person me përgjegjësi i cili ndikon direkt në aftësimin e studentëve.

8 **Buletinet** për Stafin Akademik janë të vetmet dokumente ku shihet se kush do të propozohet për zgjedhje si stafi i ri akademik dhe kush do të avancohet në tituj më të lartë akademik. Publiku mund të informohet se cili kandidat i ka plotësuar apo jo kriteret për tu zgjedhur në një titull të caktuar akademik, dhe mund të reagojnë nëse dikush është propozuar pa meritë.

9 **CV-të** e Stafit Akademik janë të rëndësishme për të parë se çfarë profesorë e çfarë stafi tjetër akademik kemi në universitete apo kolegje publike. Te këto CV mund të shihet përvoja akademike, me theks të veçantë në publikimet shkencore të anëtarëve të stafit, për të kuptuar se sa dhe ku kanë publikuar ata. Si rrjedhojë, mund të ndërtohet një pasqyrë mbi gjendjen shkencore dhe akademike të departamentit, fakultetit apo edhe të universitetit.

10 **Rregullorja për të Ardhurat Personale** tregon nivelin e kompenzimit bazë dhe shtesë për secilën kategori të stafit. Në të kaluarën rregulloret e tilla kanë mundësuar mbi kompenzime të pa arsyetuara, duke ngarkuar me mbi normë profesor të caktuar, dhe kështu duke pamundësuar punësimin e stafit të ri. Përmes këtyre rregulloreve publiku mund të kuptoj se sa paguhen p.sh. profesorët, asistentët për ligjërata dhe për punë të tjera si mentorime të diplomave apo pjesëmarrje në komisione.

11 **Buxheti** i universiteteve publike është i financuar po thuajse në tërësi nga taksapaguesi. Për këtë arsye është e rëndësishme të dihet nga publiku se cili universitet sa para merr nga qeveria e Kosovës dhe sa mund të i mbledhë vetë.

12 **Rregullorja për Zgjedhjet Studentore** është dokumenti ku vendosen kushtet dhe procedurat për zgjedhjet e përfaqësueseve studentor. Përfaqësuesit studentor përveç trupave udhëheqëse studentore marrin pjesë edhe në senatet e universiteteve publike, andaj është e rëndësishme që të kuptohet drejt kandidimi dhe zgjedhja e tyre.

13 **Përbërja e Parlamentit Studentor** është informacion ku mund të kuptojmë personat që përfaqësojnë studentët.

14 **Përbërja e Rektoratit** është informacion ku mund të kuptojmë menaxhmentin e lartë të një universiteti apo kolegji publik.

15 **Përbërja e Këshillit Drejtues** është informacion ku mund të kuptojmë personat që i drejtojnë politikat financiare dhe të përgjithshme të një universiteti apo kolegji publik.

16 **Përbërja e Senatit** është informacion ku mund të kuptojmë personat që janë përgjegjës për çështje akademike përfshirë edhe emërimin apo avancimin e stafit akademik

17 **Vendimet e Senatit** janë dokumente ku mund të kuptojmë se çfarë vendime janë marr nga senati, përfshirë datën, numrin e protokollit etj.

18 **Vendimet e Këshillit Drejtues** janë dokumente ku mund të kuptojmë se çfarë vendime janë marr nga këshilli drejtues, përfshirë datën, numrin e protokollit etj.

19 **Vendimet e Rektorit** janë dokumente ku mund të kuptojmë se çfarë vendime janë marr nga rektori, përfshirë datën, numrin e protokollit etj.

20 **Vendimet e Akreditimit** janë dokumente ku mund të kuptojmë se cilat programe studimore janë të akredituara për një periudhë të caktuar. Kjo i ndihmon studentët që të mos mashtrohen nga universitetet ose kolegjet publike për të u regjistruar në programe pa akreditim.

21 **Rregullorja për Studimet Baçelor** përshkruan të drejtat, obligimet dhe procedurat përgjatë studimeve baçelor. Studentët mund të bazohen këtu për të kërkuar të drejta të cilat nuk përshkruhen në mënyrë eksplicite në statut të një universiteti apo kolegji publik

22 **Rregullorja për Studimet Master** përshkruan të drejtat, obligimet dhe procedurat përgjatë studimeve master. Studentët mund të bazohen këtu për të kërkuar të drejta të cilat nuk përshkruhen në mënyrë eksplicite në statut të një universiteti apo kolegji publik

23 **Rregullorja për Studimet e Doktoratës** përshkruan të drejtat, obligimet dhe procedurat përgjatë studimeve të doktoratës. Studentët mund të bazohen këtu për të kërkuar të drejta të cilat nuk përshkruhen në mënyrë eksplicite në statut të një universiteti apo kolegji publik.

24 **Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë** është dokument ku parashihen hapat për të kontrolluar nivelin e cilësisë në një universitet apo kolegj publik. Mbi këtë rregullore hartohen planet për akreditim të një programi studimor dhe të vet institucionit. Publiku mund ta kuptoj nivelin e politikave të sigurimit të cilësisë përmes kësaj rregulloreje.

25 **Rregullorja për Sistemin Elektronik të Menaxhimit Studentor** është dokument kyç në caktimin se kush ka qasje në editimin e të dhënave digjitale studentore, përfshirë kush mund të vendosë apo të ndryshojë notën. Një rregullore transparente ruan të dhënat e studentëve dhe ju mundëson anonimitet në rastet kur kërkohet vlerësim të performancës së stafit akademik. Kjo rregullore po ashtu mund të përcaktoj procesin e votimit digjital të përfaqësueseve studentor apo të tjerë.

26 **Planprogrami** paraqet lëndët dhe sillabuset e secilës lëndë brenda programit studimor. Është e rëndësishme që këto të jenë publike në mënyrë që studenti të ketë mundësi të njoh mirë programin para marrjes së vendimit për të studiuar aty. Ndërkaq për publikun është e rëndësishme të kuptohet se çfarë rezultate të së nxënit janë duke përfituar studentët që vijojnë studimet aty, dhe sa përkojnë këto me nevojat në industri, shkencë, administratë apo gjetkë.

27 **Informacioni për Bursa apo Punësim** është kyç për të kompletuar misionin e universiteteve apo kolegjeve publike. Studentët duhet ta dijnë qartazi se kur mund të aplikojnë për bursa dhe cilat kritere duhet të i plotësojnë për të përfituar bursë. Për tepër informacioni për bursa jashtë vendit e pasuron përvojën studentore duke ju mundësuar atyre që potencialisht të vazhdojnë studime jashtë për të qenë pjesë e një komuniteti global të studentëve.

Ndërkaq informacioni për punësim është i domosdoshëm për të kuptuar se ku mund të pozicionohet një student nëse e kryen një program studimi.

28 **Rregullorja Kundër Ngacmimeve Seksuale** tenton të parandaloj ngacmimin seksual, të mbrojë viktimat si dhe të hapë rrugë për ndëshkimin e kryesve të ngacmimit. Një rregullore e tillë i mbron studentët e cenueshëm nga stafi të cilët shfrytëzojnë pozitën e tyre të pushtetit për notim ose tjetër për të kushtëzuar favore seksuale.

Metodologjia

Janë hulumtuar shtatë universitete publike dhe një kolegj publik. Këto paraqesin të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë të cilat kanë së paku një program studimi të akreditуar.

Me datën 2 Prill 2024 është dërguar tek institucionet e përmendura një tabelë me 28 dokumente dhe informata, dhe është kërkuar nga ata që të i vendosin vegëzat anash secilit dokument për të treguar se ku mund të gjinden ato. Institucionet kanë pasur kohë që ta plotësojnë tabelën deri me datën 15 Prill 2024.

Nga data 15 Prill 2024 deri me 20 Prill 2024 është bërë rishikimi i dokumenteve dhe informatave nga hulumtuesit e ORCA, për të bërë verifikimin e tabelave të plotësuara nga institucionet. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe hulumtuesit kanë kërkuar dokumentet dhe informatat drejtpërdrejt në uebfaqet e institucioneve të cilat nuk kanë dërguar tabela të plotësuara.

Duhet theksuar që Universiteti i Gjilanit, Universiteti i Mitrovicës dhe kolegji IBCM kanë qenë institucionet e vetme të cilat kanë dorëzuar tabela të plotësuara.

Kolegji Ndërkombëtar për Biznes në Mitrovicë (IBCM) është transformuar në një kolegj publik me 22 Mars 2023 dhe është ende në fazën tranzicionale. Si rrjedhojë, kolegji është duke hartuar dhe përditësuar rregulloret, njoftimet dhe dokumentet e tjera të cilat nuk kanë qenë të disponueshme në kohën e këtij hulumtimi.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim